



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

Nr. prot.

2612/1

Tiranë, më 15.01.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1714, datë 06.06.2014.

**SHOQËRISË "ALCANI" SH.P.K**

**Frutikulturë "Rruga e Laknasit", 100m Pranë Urës së Kamzës, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
**Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE**  
**EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM,**  
**Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria "Alcani" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1714, datë 06.06.2014, për mineral gurë gëlqeror të mermerizuar në objektin "Orenjë", Librazhd.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.3507, datë 25.04.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.2612, datë 02.05.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1714, datë 06.06.2014, për mineral gurë gëlqeror të mermerizuar në objektin "Orenjë", Librazhd, për arsye se nuk ka realizuar programin e prodhimit dhe investimet siç është përcaktuar në nenin 25, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gjurmën "f", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1714, datë 06.06.2014, për mineral gurë gëlqeror të mermerizuar në objektin "Orenjë", Librazhd, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1714, datë 06.06.2014, për mineral gurë gëlqeror të mermerizuar në objektin "Orenjë", Librazhd.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI**  
**DAMIAN GJIKNURI**

**NË MUNGESË DHE ME POROSI**  
**ZËVENDËSMINISTRI**

**ENIS ALIKO**

